

# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7820  
E enjte, 27 qershor 2024  
Çmimi 0.50

Gara për postet  
kyçë në BE  
drejt fundit



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)  
 [facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



## MARK RUTTE EMËROHET SHEF I RI I NATO-s



Aleatët e NATO-s e kanë emëruar të mërkurën kryeministrin e Holandës, Mark Rutte, shef të ardhshëm të NATO-s, njoftoi aleancën ushtarake. "Këshilli i Atlantikut Verior vendosi ta

emërojë kryeministrin holandez Mark Rutte sekretar të përgjithshëm të NATO-s, i cili do ta pasojë Jens Stoltenbergun", ka njoftuar NATO-ja. Te shefi i ri i NATO-s autoritetet në Kosovë

shohin një partner me të cilin mund të bisedojnë për një gamë të gjerë çështjesh, që nga avancimi i vendit në rrugën drejt integrimit në BE deri te siguria dhe stabiliteti afatgjatë

KUSHTETUESJA I DHA  
TË DREJTË QEVERISË  
PËR PAGËN MINIMALE,  
VETERANËT E UÇK-së  
PARALAJMËROJNË  
PROTESTA



57 PËR QIND  
E QYTETARËVE  
THONË SE  
SEKTORI I  
DREJTËSISË KA  
MBETUR I NJËJTË



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni Xhepçisht-Tetovë Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 467 300; +389 44 467 009  
Fax: +389 44 467 200  
E-mail: renova@m.t.net.mk

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website, Marketing...

AKTUALE  
UKRAINA DHE RUSIA KËMBËJNË  
TË BURGOSUR TË LUFTËS

MAQEDONCI: MIQËSIA NË MES TË  
KOSOVËS DHE KROACISË ëSHTë E  
PËRJETSHME

FSK-JA LARGON BOMBAT  
50-KILOGRAMËSHE

EKONOMI



PËR NJË MUAJ MËRGATA  
DËRGOI RRETH 120 MILIONË  
EURO NË KOSOVË

RRITET SKEMA PËR  
PENSIONET PARAPLEGJIKE  
DHE TETRAPLEGJIKE



TRAJNERI I RUBIN KAZANIT:  
DAKU DUHET TA KORRIGOJË KËTË  
GABIM ME VEPRË

## Ukraina dhe Rusia këmbejnë të burgosur të luftës



KIEV, 26 QERSHOR - Ukraina dhe Rusia kanë këmbyer 90 të burgosur të luftës, thanë zyrtarët e të dyja vendeve. Ky është këmbimi më i madh mes dy shteteve që pothuajse pesë muaj.

Moska dhe Kievi kanë kryer mbi 50 këmbime të të burgosurve që kur Rusia nisi pushtimin e Ukrainës mbi dy vjet më parë pavarësisht prej armiqësive që po vazhdojnë.

Emiratet e Bashkuara Arabe kanë ndërmjetësuar marrëveshjen e fundit për këmbimin e të burgosurve. "Sot

90 qytetarë të tjerë tanë janë kthyer në shtëpitë e tyre nga robërimi rus", tha presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky në rrjetet sociale. "Ne nuk i harrojmë të gjithë njëzit tanë që janë nën robërimin rus. Ne vazhdojmë të punojmë përlirim e secilit prej tyre", shtoi ai.

Rusia tha se 90 ushtarët e saj "që ishin në rrezik për jetë gjatë mbajtjes në robëri, janë kthyer nga territori që kontrollohet nga regjimi i Kievit".

Të burgosurit e liruar rusë më pas do të dërgohen në Moskë

"për trajtim dhe rehabilitim", tha Ministria ruse e Mbrojtjes, duke konfirmuar se Rusia ka liruar në këmbim 90 ushtarë ukrainas. Në këmbimin e fundit, që ndodhi në fund të majit, Moska dhe Kievi këmbyen 75 të burgosur. Edhe ai këmbim u realizua me ndërmjetësimin e Emiratet e Bashkuara Arabe. Ndërkohë, në shkurt të dyja palët thanë se kanë këmbyer 100 të burgosur, në këmbimin e parë të të burgosurve që kur Moska akuzoi Kievin përrëzimin e një avioni që bartte ushtarë ukrainas të zënë rob.

## Shefat e Mbrojtjes të ShBA-së dhe Rusisë bisedojnë për Ukrainën

WASHINGTON, 26 QERSHOR - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, zhvilloi një bisedë telefonike me homologun e vet rus Andrei Belousov, më 25 qershor, tha zëdhënësi i Pentagonit, Patrick Ryder, duke shtuar se Austin e "theksoi rëndësinë e ruajtjes së linjave të komunikimit në një kohë kur Rusia po kryen luftë kundër Ukrainës". Austini e inicioi thirrjen, e cila është e para mes shefave të mbrojtjes të ShBA-së dhe Rusisë që prej marsit 2023, tha Ryder. Ministria e Mbrojtjes e Rusisë tha se ata "shkëmbyen

qëndrimet e tyre për situatën e Ukrainës".

Belousov e vuri në pah rrezikun për përshtallëzim të mëtejmë të situatës për shkak të furnizimit të vazhdueshëm të Ukrainës me armë amerikane, tha Ministria ruse.

Pushtimi i Ukrainës nga Rusia dhe aneksimi i katër rajoneve ukrainase nga ajo, kanë bërë që marrëdhëniet e Moskës me Uashingtonin të bien në pikën më të ulët që prej vitit 1962, kur ndodhi kriza raketore kubane.

Javën e kaluar Moska akuzoi Shtetet e Bashkuara se janë përgjegjës për një sulm raketor

ukrainas në Gadishullin e Krimës së uzurpuar nga Rusia. Ministria e Mbrojtjes e Rusisë tha se në sulmin 23 qershorit u përfshinë pesë raketa me reze të gjata veprimi, me të cilat Shtetet e Bashkuara e kanë furnizuar Ukrainën këtë vit.

ShBA-ja e rifilloi furnizimin e Ukrainës me armë në prill, pasi Kongresi e miratoi pakon me ndihmë ushtarakë për Kievin në vlerë 61 miliardë dollarë.

Shtetet e Bashkuara thonë se i mbështesin kërkuesat e Ukrainës që Rusia t'i tërheqë trupat nga Ukraina dhe që të rivendosen kufijtë e Ukrainës pas-sovjetike.



## Gjykatësi heq pjesërisht kufizimet ndaj Trumpit në çështjen për falsifikimin e të dhënavë të biznesit

WASHINGTON, 26 QERSHOR - Një gjykatës në Manhattan hoqi disa nga kufizimet e vëna ndaj Trumpit për të komentuar publikisht ndaj dëshmitarëve dhe anëtarëve të jurisë në gjyqin penal për rastin e pagesës përtaklerë heshtjen.

Trumpi u gjet fajtor nga juria. Disa nga kufizimet e tjera do të vazhdojnë të janë në efekt derisa të vendoset masa e dënimit më 11 korrik.

Vendimi i gjykatësit Juan M. Merchan, kur kanë mbetur vetëm pak ditë nga debati i së enjtes në mes të Trumpit dhe presidentit Joe Biden, i mundëson kandidatin republikan t'i vazhdojë sulmet kundër ish-avokatit të tij Michael Cohen, aktores së filmave pornografikë Stormy Daniels dhe dëshmitarëve të tjerë të gjyqit.

Më 30 maj një juri në Nju-Jork e shpalli Trumpin fajtor lidhur me akuzat për falsifikimin e të dhënavë të biznesit përtaklerë



fshehur një skandal të mundshëm seksual, duke e bërë atë ish-presidentin e parë amerikan që gjendet fajtor përtaklerë.

Në vendimin prej pesë faqesh, gjykatësi Merchan shkruan se kishte "bindje të forta" që të vazhdonte ta ndalonte Trumpin që të komenton për anëtarët e jurisë, emrat e të cilëve nuk janë bërë publikë, por ai nuk mund ta justifikonte një gjë të tillë.

Gjykatësi la në fuqi urdhërë të veçantë që e ndalonte Trumpin dhe avokatët e tij që ta zbulonin identitetin e juristëve ose adresat e tyre. Avokati i ish-presidentit Trump, Todd Blanche, tha pas vendimit se ekipi i mbrojtjes i ka shkatërruar ato të dhëna. "Ka prova të mjaftueshme përtakët e justifikuar shqetësimin e vazhdueshëm për anëtarët e jurisë", shkruante gjykatësi Merchan në vendimin e një dite më parë.

Gjykatësi Merchan la në fuqi urdhërë që Trumpi nuk mund të komentojë përtakët e gjykatës, ekspertët e prokurorisë dhe familjet e tyre derisa të merret vendimi përtakët e ish-presidentit, duke shkruar se ata duhet të "vazhdojnë t'i kryejnë detyrat e tyre ligjore pa kërcënime, frikësimë, ngacmimë dhe dëmtime".

Këto kufizime nuk e ndalojnë Trumpin që të komentojë përtakët e gjykatës.

gjykatësin apo prokurorin Alvin Bragg, zyra e të cilët e ndoqi çështjen.

Avokatët e Trumpit i kishin kërkuar gjykatësit Merchan ta hiqte plotësisht urdhërin, duke argumentuar se nuk kishte asgjë që justifikonte kufizimin e të drejtave të ish-presidentit në bazë të Amendamentit të Parë pas përfundimit të gjyqit. Ish-presidenti Trump ka thënë se urdhri përtakët e gjykatës së Merchan në vendimin e një dite më parë.

Falsifikimi i të dhënavë të biznesit është një vepër penale përtakët e gjykatës, ekspertët e prokurorisë dhe familjet e tyre derisa të merret vendimi përtakët e ish-presidentit, duke shkruar se ata duhet të "vazhdojnë t'i kryejnë detyrat e tyre ligjore pa kërcënime, frikësimë, ngacmimë dhe dëmtime".

Këto kufizime nuk e ndalojnë Trumpin që të komentojë përtakët e gjykatës.

## Maqedonci: Miqësia në mes të Kosovës dhe Kroacisë është e përjetshme

**PRISHTINË, 26 QERSHOR** - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka thënë se miqësia në mes të Kosovës dhe Kroacisë është e përjetshme sepse i ka themelit në historinë, vlerat dhe të ardhmen e përbashkët. "Me ftesë të zëvendës-kryeministrit dhe ministrit të Mbrojtjes së Kroacisë, Ivan Anushiq, sot vizitova Kroacinë. Zhillova takim me ministrin Anushiq. Partneriteti, në veçanti

bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë, është në nivelin më të lartë. Me ministrin Anushiq shqyrtuan mundësitë e thellimit të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, diskutuan rreth situatës së sigurisë në region si dhe në nivel global. Ministrin Anushiq e falenderova për mbështetjen e vazdueshme dhe

shumëdimensionale nga Kroacia për Kosovën si dhe konfirmova vendosmërinë e institucioneve të Kosovës për anëtarësim në strukturat euroatlantike. Gjatë vizitës nënshkruam marrëveshjen për shkollimin e kadetëve të FSK-së në Akademinë Ushtarake 'Franjo Tugman' e që rrit edhe më tej kapacitetet tona humane në mbrojtje dhe siguri", ka njoftuar Maqedonci.



## Kushtetuesja i dha të drejtë qeverisë për pagën minimale, veteranët e UÇK-së paralajmërojnë protesta



**PRISHTINË, 27 QERSHOR** - Ushtruesi i detyrës së kryetarit të Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, Faton Klinaku, ka reaguar pasi Gjykata Kushtetuese i ka dhënë të drejtë Qeverisë së Kosovës në lidhje me pagat e veteranëve të cilat nuk janë përfshirë në rritjen e pagës minimale. Klinaku ka paralajmëruar se do të vazhdojnë protestat, duke shtuar se ky pushtet në vazhdimesi ka punuar kundër veteranëve të luftës së UÇK-së. "Qëndrimet tona se do t'i vazhdojmë protestat kundër këtij pushteti i cili vazhdimesht ka punuar kundër veteranëve të luftës së UÇK-së dhe shtresave të tjera të shoqërisë, mbeten të pandryshueshme. Për format dhe kohën e protestimit do të takohemi si organe drejtuese për të vendosur", ka shkruar Klinaku

në "Facebook". Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim për ankesën e shefit të grupit parlamentar të AAK-së, Besnik Tahiri dhe 9 deputetë të tjerë lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë që përcaktojnë shumën e benefacionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore. Sipas Kushtetueses, ky ligj nuk është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. Kushtetuesja ka vlerësuar se ndryshimet e ligjeve përveteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për të verbit, për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë nuk janë në kundërshtim me nenin kushtetues për barazi para ligjit.



## FSK-ja largon bombat 50-kilogramëshe

Prishtinë, 26 qershor - Në një operacion të përbashkët, ekipet e çminimit të Gardës Kombëtare të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe të ekipit të EOD-së nga kampi Bondsteel i ushtrisë amerikane, kanë arritur t'i largojnë tri bomba SC-50 Gjermane, të mbeturë që nga

Lufta e Dytë Botërore. Bombat janë gjetur gjatë punimeve në rrugën magjistrale Prishtinë - Podujevë, në fshatin Shakovicë, të cilat janë bartur në vend të sigurt, për t'i demoluar më pas, sipas planifikimeve të ekipave të çminimit.



## Oficeri i FSK-së përfundon me sukses kursin e Komandës së Përbashkët dhe Shtabit të Përgjithshëm në Estoni

Prishtinë, 26 qershor - Oficeri i FSK-së, major Kreshnik Zeneli, ka përfunduar me sukses trajnimin e Komandës së Përbashkët dhe Shtabit të Përgjithshëm në Kolegjin Baltik të Mbrojtjes në Estoni. Trajnim i synon arsimimin

profesional ushtarak të fokusuar në nivelin operacional për të përgatitur oficerë të lartë ku testohen në 12 module, e major Zeneli ka përfunduar me sukses të lartë akademik të gjitha modulet e trajnimit.

Përfundimi i studimeve ka kulmuar me ushtimin "Joint Resolve - Warshaw 2024", që janë zbatuar njohuritë e fituara gjatë trajnimit, duke u fokusuar fuqishëm në operacionet e përbashkëta aleate në të gjithë spektrin e operacioneve.



## Mark Rutte emërohet shef i ri i NATO-s

Aleatët e NATO-s e kanë emëruar të mërkurën kryeministrin e Holandës, Mark Rutte, shef të ardhshëm të NATO-s, njoftoi aleanca ushtarake. "Këshilli i Atlantikut Verior vendosi ta emërojë kryeministrin holandez Mark Rutte sekretar të përgjithshëm të NATO-s, i cili do ta pasojë Jens Stoltenbergun", ka njoftuar NATO-ja. Te shefi i ri i NATO-s autoritetet në Kosovë shohin një partner me të cilin mund të bisedojnë për një gamë të gjerë çështjesh, që nga avancimi i vendit në rrugën drejt integrimit në BE deri te siguria dhe stabiliteti afatgjatë.

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 26 qershor - Aleatët e NATO-s e kanë emëruar të mërkurën kryeministrin e Holandës, Mark Rutte, shef të ardhshëm të NATO-s, njoftoi aleanca ushtarake. Emërimi i Ruttes u bë formalitet pasi rivali i tij i vetëm për këtë pozitë, presidenti rumun Klaus Iohannis, njoftoi javën e kaluar dorëheqjen nga gara, pasi kishte dështuar të siguronte mbështetje.

"Këshilli i Atlantikut Verior vendosi ta emërojë kryeministrin holandez Mark Rutte si sekretar të përgjithshëm të NATO-s, i cili do ta pasojë Jens Stoltenbergun", tha NATO-ja në një komunikatë. Rutte do ta marrë detyrën e sekretarit të përgjithshëm të aleancës ushtarake nga 1 tetori 2024, kur i mbaron mandati shefit të tanishëm Jens Stoltenbergut, tha ajo. Pasi shfaqi interesim për këtë pozitë vitin e kaluar, Rutte fitoi mbështetje të menjëherëshme nga

anëtarët kyçë të aleancës, përfshirë Shtetet e Bashkuara, Britaninë, Francën dhe Gjermaninë.

Të tjerrët ishin më të rezervuar, posaçërisht vendet e Evropës Lindore që argumentuan se kjo pozitë duhet të mbahet nga dikush prej rajonit të tyre për herë të parë. Megjithatë, ata në fund e mbështetën Rutten, i cili është një kritik i ashpër i presidentit të Rusisë, Vladimir Putin, dhe aleat i patundur i Ukrainës.

Stoltenberg, i cili ka 10 vjet në krye të NATO-s, tha se po e lë aleancën në "duar të sigurta" dhe e quajti Ruttes lider të "fuqishëm transatlantik". "E mirëpres vendimin e aleatëve të NATO-s për ta zgjedhur Mark Rutten si pasuesin tim. Mark është një transatlantik i mirëfilltë, një lider i fuqishëm. I uroj atij sukses teksha ne vazhdojmë ta forcojmë NATO-n për sfidat e tanishme dhe të ardhshme", tha Stoltenbergu.

NATO-ja merr vendime me bashkëpajtim, prandaj Rutte, i cili po largohet nga politika në Holandë pas gati 14 vjetësh, mund

të konfirmohej vetëm pasi ta fitonte mbështetjen e të gjitha 32 vendave anëtare.

Rutte do të përballet me sfidën për ta ruajtur mbështetjen e aleatëve për luftën e Ukrainës kundër Rusisë, duke e siguruar njëkohësisht që NATO-ja të mos zhytet në luftë me Moskën.

### Lidhjet e Mark Ruttes me Kosovën ndër vite

Te Mark Rutte autoritetet në Kosovë shohin një partner me të cilin mund të bisedojnë për një gamë të gjerë çështjesh - nga avancimi i vendit në rrugën drejt integrimit në Bashkimin Evropian deri te siguria dhe stabiliteti afatgjatë.

Në krye të qeverisë holandeze nga viti 2010, Rutte u emërua në pozitën e sekretarit të përgjithshëm të NATO-s më 26 qershor.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e uroi Rutten të mërkurën për postin e ri dhe tha se mezi pret të punojë me të përt ta cuar përparrë

synimin e Kosovës për t'u bashkuar NATO-s, si dhe për të punuar "për paqe dhe siguri afatgjatë në kontinentin tonë dhe më gjérë". "Përvoja, liderishtë dha ditura e tij do të jenë të vlefshme për aleancën! Për gjatë viteve ne kemi punuar së bashku për shumë çështje të rëndësishme dhe nuk dysho se bashkëpunimi ynë i fuqishëm do të vazhdojë teksha ai e merr përsipër këtë përgjegjësi të re", shkroi Osmani në X.

Vizitën e fundit në Kosovë Rutte e zhvilloi korrikun e kaluar, kur së bashku me homologun e atëhershëm nga Luksemburgu, Xavier Bettel, i bënn thirje Kosovës dhe Serbisë t'i ulnin tensionet dhe t'i kthehen dialogut për normalizimin e marrëdhënieve.

Osmani e takoi për herë të fundit Rutten javën e kaluar, në marginin e një samiti për paqen në Ukrainë, që u mbajt në Zvicër. "Samiti ishte një mundësi e shkëlqyer për të biseduar me kryeministrin holandez Mark Rutte për rëndësinë e së ardhmes euroatlantike të Kosovës", shkroi

# 57 për qind e qytetarëve thonë se sektori i drejtësisë ka mbetur i njëjtë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 26 QERSHOR** - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar të mëkurën rezultatet e sondazhit më të fundit me qytetarë, në të cilin janë shpalosur këndvështrimet e tyre mbi sektorin e Drejtësisë.

Në konferencë u përmendën edhe gjetjet nga raporti i fundit i KDI-së, i cili ka përbledhur një vlerësim të përgjithshëm mbi dinamikën e reformës në drejtësi në këto tre vite e gjysmë të qeverisë Kurti.

Raporti vlerëson se reforma në drejtësi, që ishte një ndër prioritetet kryesore të qeverisë Kurti, edhe pse u materializua në disa nisma të rëndësishme ligjore, nuk ka arritur të përblyhet dhe t'i përbushë pritshmëritë e qytetarëve për një gjyqësor më efektiv dhe trajtim më efikas të rasteve të korrupsionit.

Mungesa e qartësisë dhe konsensusit politik mbi përbajtjen e reformës, polemikat e shumta midis qeverisë dhe kërëve të institucioneve të drejtësisë lidhur me ndryshimet legislative si dhe dilemat mbi kushtetutshmërinë e ligjeve që prekeshin nga reforma e shoqëruan procesin që nga fillimi.

Pavarësisht prej përfshirjes aktive të organizatave të shoqërisë civile në të gjitha platformat e diskutimit, ndikimi i tyre në vendimarrje ishte shumë i kufizuar për shkak të

mbizotërimit të perspektivës së qeverisë në procesin legislativ. Përfundimisht, mungesa e informimit të publikut lidhur me përbajtjen e reformës dhe mundësitet që publiku të përfshihej në proces ishin evidente thuajse në të gjitha sondazhet e realizuara për dy vjet nga KDI, duke vënë në pah domosdoshmërinë e një komunikimi më të hapur dhe më përbajtjesor të qeverisë me qytetarët lidhur me efektet praktike që po synoheshin nga kjo reformë.

Raporti u fokusua në vlerësimin e shtyllave kryesore të reformës, vetingun për kërët e institucioneve të drejtësisë, reformat në Këshillin Prokurorial dhe Projekt-ligjin për Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustifikueshme të zyrtarëve publikë.

Sipas KDI, qeveria duhet të vijë me alternativë tjetër për jetësimin e vetingut, pasi miratimi i amendamenteve kushtetuese kërkon edhe votat e Listës Serbe. Në anën tjetër, Ligji për Këshillin Priokurorial duhet t'i adresojë opinionet e Komisionit të Venecias dhe ta përfundojë leximin e dytë pa vonesa. Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese në trajtimin e Projektit të Byrosë ka tejkaluar periudhën optimale të dhënieve së përgjigjes duke vënë në pritje zbatimin e këtij ligji. Duke iu rikthyer të dhënavë nga sondazhi i fundit, i realizuar nga 6-15 qershor, Arbër Thaçi tha se ky sondazh ka në fokus procesin e vazhdimit të reformës në



drejtësi gjatë këtyre tri viteve të qeverisjes Kurti. Pjetjet e parashtruara ndaj qytetarëve synojnë të vënë në pah tri çështje kryesore: performancën e sektorit të drejtësisë gjatë këtyre tri viteve, njohuritë e qytetarëve mbi Ligjet e Reformës në Drejtësi dhe aspektet më të rëndësishme të sektorit të drejtësisë sipas qytetarëve, në të cilat duhet të vazhdojnë reformat.

Kështu, në pyetjen e parë drejtuar qytetarëve se si e vlerësojnë ata performancën e institucioneve të drejtësisë (gjykatave dhe prokurorive) krahasuar me tri vite më parë, 57,2 % janë deklaruar se performanca e gjykatave dhe prokurorive ka mbetur e njëjtë gjatë kësaj periudhe. Në anën tjetër, vetëm 19,8 % e qytetarëve vlerësojnë se performanca e këtyre institucioneve është përmirësuar, krahas 17,8 % që mendojnë se është përkëqësuar. Ndërsa 5,3 % e të anketuarve janë shprehur se nuk e dinë apo kanë

refuzuar të përgjigjen. Pyetja e dytë drejtuar qytetarëve, se për cilat nga iniciativat ligjore në kuadër të reformës në drejtësi kanë dëgjuar, ku ata kanë pasur mundësi të përzgjedhin më shumë se një opsjon, ka vënë në pah se në përqindje mjaft të lartë 29,9 % e qytetarëve vazhdojnë të mbeten të painformuar me projektligjet dhe ligjet e miratuara në kuadër të reformës në drejtësi. Në anën tjetër, 28,3 % e tyre kanë dëgjuar lidhur me vetingun në sektorin e drejtësisë, 27,6 % lidhur me Ligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme ndaj personave zyrtarë, 27,2 % kanë dëgjuar lidhur me ndryshimet në Kodin Penal të cilat kanë ashperuar dënimet për dhunën në familje. Kurse qytetarët më pak kanë dëgjuar lidhur me iniciativën për krijimin e Gjykates Administrative, me vetëm 19,4 % e tyre që kanë dëgjuar për një gjë të tillë. 17,5 % e tyre kanë dëgjuar lidhur me Ligjin për Këshillin

Prokurorial që synon ndryshimin e përbërjes së këtij Këshilli, kundrejt 13,8 % e tyre që kanë dëgjuar lidhur me krijimin e Gjykates Komerciale.

Thaçi vijoi me përgjigjet e pyetjes së fundit drejtuar qytetarëve në të cilën ata kanë pasur mundësi të përzgjedhin për nga rëndësia më e madhe tek më pak e rëndësishme, se në cilat aspekte të sektorit të drejtësisë duhet të vazhdojnë reformat në drejtësi. Lidhur me këtë, 30,3 % e qytetarëve presin që reforma në drejtësi të vazhdojë në zvogëlimin e vonesave në trajtimin e rasteve në gjykata, si aspekti më i rëndësishëm për ta. Si çështje e dytë ata mendojnë se reforma duhet të vazhdojë në rritjen e ndëshkimeve për gjyqtarët dhe prokurorët me performance të dobët, me 22,9 % e tyre që kanë përzgjedhur këtë aspekt si zgjedhje e dytë. Në anën tjetër, më pak të rëndësishme për qytetarët janë mbikëqyrja më e madhe e punës së prokurorëve dhe gjyqtarëve, ku 19,8 % e tyre e kanë përzgjedhur këtë si zgjedhje të tretë, ndërsa 22,6 % si zgjedhje të katërt për nga rëndësia. Në një përqindje relativisht të lartë prej 48,6 %, qytetarët kanë thënë se reforma nuk duhet të fokusohet në rritjen e pagave për punëtorët e sektorit të drejtësisë.

Ky hulumtim i opinionit publik është realizuar me metodën e Omnibusit, në të cilin kanë marrë pjesë 1 065 respondentë të moshës mbi 18 vjeç. Periudha e anketimit përfshin datën nga 6 deri më 15 qershor 2024.

Osmani asokohe.

Holanda ishte në mesin e shteteve që e njohën pavarësinë e Kosovës brenda muajit të parë pas shpalljes, më 2008. Atëkohë kryeministri ishte Jan Peter Balkenende.

Rutte mori detyrën e kryeministrit mbi dy vjet më vonë, në tetor të 2010-s.

Në dhjetor të 2013-s ai priti në zyriën e tij presidenten e atëhershme të Kosovës, Atifete Jahjaga, së cilës i shprehu mbështetjen e Holandës për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimt në mes të Kosovës dhe BE-së.

Kjo marrëveshje - e para kontruale mes dy palëve - u nënshkrua në vitin 2015.

Qeveria e Ruttes për një periudhë të caktuar ishte kundërshtare e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës së bashku me atë të Francës. Një qëndrim i tillë i nxiti dhjetëra deputetë të Parlamentit Evropian i shkuan letër Ruttes dhe presidentit të Francës, Emmanuel Macron, në vitin 2020, për t'u kërkuar dritën jeshile për lëvizjen e lirë të kosovarëve. Nga ajo kohë, procesi kaloi në disa fazë dhe vizat u hoqën nga 1 janari i këtij viti.

## Si e arriti Rutte majën e NATO-s?

Sekretarët e përgjithshëm të NATO-s zgjidhen me konsensus nga të 32 vendet anëtare. Ruttes iu hap rruga pasi vende si Hungaria, Sllovakia dhe Rumania - përkundër hezitimeve fillestare - dhanë dritën jeshile.

Për pozitën u përfolën edhe emra të tjerë, si ai i presidentit rumun Klaus Iohannis, apo i kryeministres estoneze Kaja Kallas, por nuk shkuan përpëra. Rutte pritet ta marrë zyrtarisht detyrën më 1 tetor nga shefi i deritashëm i NATO-s, Jens Stoltenberg.

Rutte, 57 vjeç, është aleat i Ukrainës dhe kritik i ashpër i presidentit rus Vladimir Putin. Ai ka qenë një nga mbështetësit më të mëdhenj të ndihmës ushtarake evropiane për Ukrainën prej se Rusia ka nisur pushtimin në shkallë të plotë të saj në vitin 2022.

Mundja në fushëbetëjë e Rusisë është jetike për ta siguruar paqen në Evropë, thotë Rutte. Në udhëheqjen e tij, Holanda i ka rritur shpenzimet e mbrojtjes në



më shumë se 2 % të bruto prodhimit të rendshëm - prag ky që u kërkohet të gjitha vendve anëtare të NATO-s.

Rutte do të tërhiqet zyrtarisht nga pozita e kryeministrit kur qeveria holandeze e krahut të djathë ta zëvendësojë koalicionin e tij të qendrës së djathë - me gjasë brenda disa javësh.

Rutte, fillimisht, ka lënë të

kuptohet se mund t'i pëlqejë të ligjerojë pas politikës por, më pas, ka përmendur luftën në Ukrainë si arsyë përsë ka kërkuar një post ndërkombëtar.

Stoltenbergu tha më herë se Rutte është një kandidat "shumë i fortë" për ta zëvendësuar atë. Në Stoltenbergun, i cili mori detyrën e shefit të NATO-s në vitin 2014, aleanca ushtarake u zgjerua me katër anëtarë të rinj:

Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Finlandë dhe Suedinë. Gjatë udhëheqjes së tij NATO-ja përforcoi edhe misionin paqeruajtës në Kosovë vitin e kaluar, pas rritjes së tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe, ndërsa Asambleja Parlamentare e aleancës miratoi avancimin e statusit të Kosovës nga anëtare të asocuar.

## Nura pret Szunyogin, flasin për bashkëpunimin e dyanshëm

**SKENDERAJ, 26 QERSHOR** - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, së bashku me drejtorin për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, Ylber Morina dhe drejtorin për Arsim, Kastriot Duraku, kanë pritur në takim

shefin Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, me bashkëpunëtorë. Në takim është diskutuar për bashkëpunimin në mes të BE-së në Kosovë dhe komunës së Skenderajt, me theks të veçantë për projektin e

ndërtimit të çerdhes publike afër Shkollës Filllore "Shaban Jashari".

Me këtë rast është vizituar objekti i çerdhes, ku kanë parë nga afër ecurinë e punimeve të cilat ndodhen në fazën e fundit të përfundimit.



## Mbahet takimi me qytetarët për gjashtëmuajrin e parë të komunës së Kamenicës

**KAMENICË, 26 QERSHOR** - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, ka mbajtur takimin publik me qytetarë për punën e ekzekutivit për gjashtëmuajrin e parë të vitit 2024.

I pari i komunës këtë takim e ka hapur duke paraqitur punët e bëra në këtë gjashtëmuaj. Ai ka thënë se edhe ky gjashtëmuaj karakterizohet me llogaridhënie, investime në infrastrukturë, subvencione dhe skema sociale, politikëbërje. "Për 31 muaj qeverisje kemi 41 zotime të përfunduara, 12 zotime të filluara dhe 3 të pafilluara nga gjithsej 56 zotime. Mirépo ne



kemi bërë shumë më shumë punë sesa zotimet. Ne do të vazhdojmë të sjellim edhe më shumë sesa këto zotime të dhëna", ka thënë ai.

Kryetari Rahimaj ka folur për investimet në ujin e pijshëm të cilat kapin vlerë prej 1.2 milion eurosh, pastaj asfaltimin e rrugëve të brezit kufitar në vllere

13.1 milionë euro, rrugët e ndërtuara në bashkëpunim me MMPHI-në në vlerë mbi 1 milion euro. Në këtë takim nga i pari i komunës janë paraqitur edhe investimet e tjera si në ndërtimin e vend-parkingjeve dhe parkut të lojërage në vlerë 149,981 mijë euro, ndërtimin e kolektorit në Koretin në vlerë mbi 331 mijë euro, ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në Novosellë në vlerë mbi 263 mijë euro, ndërtimin e urës metalike në Koretin në vlerë mbi 81 mijë euro, ndërtimin e trotuareve të reja në vlerë mbi 216 mijë euro, rinovimin e shkollave në vlerë mbi 160 mijë euro, terrene të reja sportive në vlerë mbi 103 mijë euro, fillimin e punimeve për unazën e qytetit në vlerë mbi 980 mijë euro, zgjidhjen e problemit me qentë endacakë në vlerë mbi 19 mijë euro, ndërtimin e Parkut të Aventurave në vlerë mbi 280 mijë euro, përrurimin e punimeve të bëra në QPS në vlerë prej 117 mijë eurosh.

Mirépo nuk ishin vetëm investimet kapitale punët të cilat i paraqiti kryetari Rahimaj, pasi që gjatë këtij takimi ai ka paraqitur edhe investimet aktive të cilat janë në vlerë mbi 32 milionë euro.

## Komuna e Drenasit ofron shërbime të analizave të gjëndrës tiroide pa pagesë

Drenas, 26 qershor - Komuna e Drenasit ka nisur një iniciativë të re që ofron shërbime të analizave të gjëndrave tiroide pa pagesë, duke e bërë kështu të parën në nivel vendi. Programi plotëson standardin e aplikueshëm laboratorik bazuar në Udhëzimin Administrativ UA 04/2020. "Ky shërbim është një hap drejt përparimit të shëndetit publik, duke siguruar qasje të lehta për analiza të rëndësishme shëndetësore për qytetarët e Drenasit. Komuna synon ta përmirësojë kujdesin shëndetësor dhe të sigurojë një standard cilësor të shërbimeve laboratorike për qytetarët e saj", ka njoftuar komuna e Drenasit.

Më tej thuhet se iniciativa ka për qëllim të ndihmojë në zbatimin e praktikave më të mira të shërbimeve shëndetësore dhe ta



rrisë ndërgjegjësimin për shëndetin e gjëndrës tiroide në komunitetin tonë.

Duke vlerësuar se shërbimi i analizave laboratorike për gjëndrën tiroide ka qenë shumë i kushtueshëm, komuna e Drenasit ka investuar në pajisjet e nevojshme për të ofruar këtë shërbim falas për qytetarët.

## Hyseni priti komandantin e KFOR-it, biseduan për sigurinë

**GJILAN, 26 QERSHOR** - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka pritur komandantin e KFOR-it të udhëhequr nga NATO-ja, gjeneralmajor Ozkan Ulatas.

Në takim u shkëmbyn mendime për trendet e fundit të sigurisë, për aktivitetet e KFOR-it dhe mbështetjen ndaj dialogut të lehtësuar nga BE-ja.

I pari i Gjilanit tha se kishte nderin të presë përvizitë në komunën e komandantit e KFOR-it në Kosovë, gjeneralmajor Ozkan Ulatas. "Bashkëbiseduam përmes e çështje të ndryshme, nga siguria

në vendin tonë e deri te përvojat e ndryshme të gjeneralit Ulatas", ka thënë Hyseni.

Kryetari i Gjilanit ka theksuar se bashkëpunimi me KFOR-in vazhdon të jetë i nevojshëm për sigurinë e regjionit dhe Ballkanit.

Më tej shtoi se janë për siguri, paqe dhe jetë të qetë, për të gjithë, pa dallim, në Republikën e Kosovës.

Ndërsa komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Ozkan Ulatas, ka theksuar angazhimin e qëndrueshëm të KFOR-it përmes mbështetje të stabilitetit rajonal.



## Një delegacion i Kuvendit Komunal të Podujevës po qëndron në vizitë zyrtare në Velbert të Gjermanisë

**PODUJEVË, 26 QERSHOR** - Delegacioni nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, i udhëhequr nga kryesuesi i kuvendit, Hilmi Hoxha dhe i përbërë nga asamblistët e të gjitha partive politike, po qëndrojnë në vizitë zyrtare në qytetin e Velbertit.

Gjatë vizitës u priten nga deputeti gjerman në Parlamentin Evropian, Peter

Beyer, përfaqësuesi nga Ministria e Financave, dr. Paul - Jurgen Stein, si dhe përfaqësuesi i shqiptarëve në komunën e Velberit, Rrahman Islami.

Gjatë takimit u diskutuan çështje të ndryshme, mundësítë e bashkëpunimit mes dy komunave dhe shkëmbimi i përvojave të mira me njëra-tjetrën.

Delegacioni zhvilloi takim edhe me kryetarin e komunës së Velberit, Dirk Lukrafka, anëtarët e kryesisë së CDU dhe anëtarët e kuvendit.

Kryesuesi i kuvendit, Hilmi Hoxha, i falënderoi për pritjen dhe bashkëpunimin e deritashëm, me ç'rast ndau dhurata dhe mirënjojje përtatë.



# Gara për postet kyçë në BE drejt fundit



**BRUKSEL, 26 QERSHOR** - Udhëheqësit e 27 shteteve anëtare të Bashkimit Evropian takohen në Bruksel më 27-28 qershor, kur pritet të vendosin se kush do t'i marrë postet kyçë në institucionet e ndryshme të bllokut. Postet kyçë janë tre presidentët - të Komisionit Evropian, të Këshillit Evropian dhe të Parlamentit Evropian - dhe ai i shefit të politikës së jashtme të bllokut.

Sipas të gjitha gjasave, kandidatja gjermane e qendrës së djathtë nga Partia Popullore Evropiane (EPP), Ursula von der Leyen, do të marrë edhe një mandat pesëvjeçar si presidentë e Komisionit Evropian, krahut ekzekutiv të BE-së. Njësoj edhe bashkëpartiakja e saj nga EPP-ja, politikanja nga Malta, Roberta Metsola, pritet ta mbajë postin e presidentes të Parlamentit Evropian edhe për dy vjet e gjysmë. (Ajo më pas do t'ia dorëzojë këtë detyrë kandidatit nga grupi i dytë më i madh në PE, Aleancës Progresive të Socialistëve nga qendra e majtë dhe Demokratëve (S&D), sipas një marrëveshjeje për ndarjen e pushtetit në PE).

Konsensusi i përgjithshëm është se ish-kryeministri portugez i krahut të majtë, Antonio Costa, do ta zëvendësojë Charles Michel në postin e presidentit të Këshillit Evropian, dhe kryeministrja e Estonisë, Kaja Kallas nga grupi liberal, Renew, do ta zëvendësojë spanjollin Josep Borrell në udhëheqjen e politikës së jashtme të bllokut.

Ka pasur shpresat që ky proces të kishte përfunduar javën e kaluar, më 17 qershor, gjatë takimit joformal në Bruksel të udhëheqësve të BE-së. Por, sipas disa burimeve me të cilat ka biseduar Radio Evropa e Lirë, e të cilat kanë njofturi për këto diskutime, dy gjëra pamundësuan arritjen e një marrëveshjeje.

E para, EPP-ja, e cila doli fituese në zgjedhjet e fundit për Parlamentin Evropian, po kërkon më shumë. Sipas burimeve të Radios Evropa e Lirë, përvèç presidencës së Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian, EPP-ja po ashtu dëshiron të marrë gjysmën e punës së presidentit të Këshillit Evropian.

Por, si do të funksiononte një gjë e tillë? Përderisa presidenti i Këshillit Evropian ka një mandat pesëvjeçar, pas dy vjetësh e gjysmë, kërret e 27 shteteve anëtare vlerësojnë punën e bërë nga zyra e presidentit - dhe të paktën deri më tanë - ia rinovojnë mandatin edhe për dy vjet e gjysmë të tjerë. Votimi është kryer përmes sistemit të votimit me shumicë të kualifikuar që nënkuption 55 për qind të shteteve anëtare të BE-së që përfaqësojnë 65 për qind të popullsisë së përgjithshme të bllokut.

Normalisht, grupi më i madh politik në Parlament paraqet kandidatin e tij për postin e presidentit të Komisionit Evropian, ndërkohq grupi i dytë dhe i tretë marrin pozitën e presidentit të Këshillit Evropian dhe të shefit për politikë të jashtme.

EPP-ja ka sugjeruar se Costa, kandidati kryesor për këtë post, të shërbejë vetëm gjysmë mandati dhe më pas të zëvendësohet nga kryeministri kroat, Andrej Plenkoviç. Ky propozim i EPP-së nuk u prit mirë.

Por, pse EPP-ja po ndihet kaq e sigurt? Sigurisht, ajo ka korru rezultatet të mira në zgjedhjet për Parlamentin Evropian - grupi i vetëm që ka fituar më shumë vota - duke dalë e para me një dallim prej 190 ulësesh me grupin e dytë.

Më shumë ka të bëjë me përbëren e Këshillit Evropian, i cili përbëhet nga kërret e shteteve apo qeverive të 27 shteteve anëtare të BE-së. Trembëdhjetë udhëheqës në Këshill i përkasin EPP-së, megjithëse janë kryesishët nga shtete më të vogla, me Poloninë si shteti më i madh në mesin e tyre. Dhe EPP-ja po kërkon më shumë duke llogaritur se brenda dy vjetësh do të ketë liderë të rinj të EPP-së që mund të vijnë nga shtete me peshë të madhe, sikurse me peshë të madhe, sikurse Gjermania dhe Spanja. Nëse një llogaritje e tillë del e saktë, atëherë EPP-ja do të kishte në Këshill më shumë se një shumicë të kualifikuar.

Faktori i dytë që pamundësoi që të arrihej marrëveshja javën e kaluar ishte vetë procesi. Siç duket, kryenegociatorët nga tri grupet kryesore parlamentare - kryeministri polak, Donald Tusk dhe ai grek, Kyriakos Mitsotakis nga EPP-ja; kancelari gjerman, Olaf Scholz, dhe kryeministri spanjoll, Pedro Sanchez nga S&D; dhe presidenti i Francës,

Emmanuel Macron, dhe kryeministri i Holandës, Mark Rutte nga Renew - diskutuan përmarrëveshjen për tri orë, duke mos përfshirë liderët e tjera në diskutime.

Kryeministria e Italisë nga krahë i djathë, Giorgia Meloni, anëtare e grupit të Konservatorëve dhe Reformistëve Evropianë (ECR), ishte, sipas burimeve të REL-it, e zemëruar përmështimin nga bisedimet. Subjekti e saj, Vëllezerit e Italisë, është anëtari më i fortë i ECR-së, grup që doli i katërti në zgjedhjet evropiane. Që nga samiti i 17 qershorit, ECR-ja ka arritur të marrë disa anëtarë pa grup parlamentar dhe të kalojë Renew, duke u bërë grupi i tretë më i madh parlamentar.

Nuk është e qartë se çfarë dëshiron të përfitojë Meloni duke ndërmarrë këtë qëndrim. Nuk besohet se ajo është e interesuar që të marrë një nga katër postet kyçë të BE-së, por është e prirë të shtyjë përparranë portofolio italiane në Komisionin Evropian. (Kjo mund të nënkuption, për shembull, marrjen e postit të zëvendëspresidentit me mandat përfushën e ekonomisë apo migrimit). Ky qëndrim është një rikujtim se më i rendësishëm se katër postet janë personat që punojnë në prapaskenë.

Nëse udhëheqësit e BE-së pajtohen për postet kryesore, testi i vërtetë do të vijë nga Parlamenti Evropian. Udhëheqësit e BE-së nuk kanë realisht fuqinë e votës kur bëhet fjalë për presidentin e Parlamentit. Kjo është

përgjegjësi e vetë Parlamentit, që pritet të zgjedhë Metsolan me një shumicë të thjeshtë në Strasburg më 16 korrik. Në anën tjeter, Parlamenti nuk mund të vendosë përgjedhjen e presidentit të Këshillit Evropian. Ky post kërkon shumicën e kualifikuar të udhëheqësit e shteteve anëtare.

Përgjedhjen e presidentit të Komisionit Evropian dhe të shefit të diplomacisë, situata është më e ndërlikuar. Këto poste kërkojnë shumicën e kualifikuar të udhëheqësve dhe më pas, zgjedha e tyre duhet të kalojë edhe përmes Parlamentit Evropian përmes një shumice të thjeshtë. Thënë shkurt, të gjitha postet janë në tavolinë të negocimit.

Më 2019, presidentja aktuale e KE-së, Von der Leyen, arriti të zgjidhej në këtë post në Parlamentin Evropian përvetëm nëntë vota më shumë nga sa kërkohen. Votimi në korrik kësaj here mund të jetë më i ngushtë, pasi ka më pak eurodeputetë nga katër grupet kryesore (EPP, S&D, Renew, dhe të Gjelbrit) sesa herën e kaluar, dhe Von der Leyen me gjasë nuk mund të llogarisë në votat e eurodeputetëve nga grupet e tjera parlamentare.

Nëse Parlamenti Evropian tregon muskujt dhe nuk e zgjedhë atë, udhëheqësit duhet sërisht të mblidhen dhe të gjejnë një kandidat alternativ që mund të mbledhë 361 votat e nevojshme në Parlament.

(Përgatiti: Mimoza SADIKU / Rel)

## Murati: Vitin e kaluar pati mbi 442 mijë llogari aktive në Trust

**PRISHTINË, 26 QERSHOR** - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se numri i llogarive aktive në Trust gjatë vitit 2023 ka qenë 442 mijë e 383. Ai ka thënë se "opozita ka kontestuar shifrat e ATK-së dhe ASK-së". "Sipas raportit vjetor të Trustit, numri i llogarive aktive në vitin 2023, pra llogarive që kanë paguar

kontribute, ka qenë 442 383. Zakonisht e kemi dëgjuar opozitën t'i kontestoje shifrat e ATK-së dhe ASK-së, me pretendimin që nuk janë të sakta, dhe se numri i llogarive aktive në Trust është indikatori më i mirë. Pa hyrë në diskutime se cili indikator është më i saktë, ja edhe numrat e Trustit, që edhe kësaj radhe

demanotjnë opozitën. P. s.: Në vitet 2019 dhe 2021 ka pasur zgjedhje, prandaj edhe numrat e llogarive aktive në Trust mund të janë më të fryra në këto dy vjet meqenëse ka një numër të konsiderueshëm të vëzhguesve e komisionarëve që raportohen si llogari aktive", ka shkruar Murati në "Facebook".



## Rritet skema për pensionet paraplegjike dhe tetraplegjike



**PRISHTINË, 26 QERSHOR** - Në muajin maj 2024 nga skema për Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike kanë përfituar 3 028 që, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak që kanë qenë 2 647 përfitues, vërehet rritje prej 14,4 %. Në muajin maj 2024, krahasuar me muajin maj 2023, kishte rënë të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet e Trepçës (-19,4 %); skema për pensionet invalidore (-17,3 %); skema e ndihmës sociale (-9,1 %); skema për pensionet familjare (-6,4 %); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,2 %). Në muajin maj 2024, krahasuar me muajin maj 2023, kishte rritje të numrit të përfituesve nga:

Skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (12,9 %); skema e pensioneve për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) (12,2 %); Skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (8,2 %); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (6,1 %); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (3,4 %); skema e kompensimeve për personat e verbër (2,6 %); skema e pensioneve bazike të moshës (2 %); skema e pensioneve kontribut-paguese të moshës (0,2 %); skema për veteranët e luftës (0,4 %).

## Për një muaj mërgata dërgoi rrith 120 milionë euro në Kosovë

**PRISHTINË, 26 QERSHOR** - Rreth 120 milionë euro është vlera preliminare e dërgesave të mërgatës që janë sjell në Republikën e Kosovës për muajin maj 2024. Kështu thuhet në statistikat e remitancave dhe institucioneve të tjera financiare (jobanka) për muajin maj 2024 të publikuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), duke shtuar se vlera totale e tyre për pesë muaj, sipas vlerësimeve preliminare, ka arritur në 513.99 milionë euro. Sipas raportit, prurjet më të mëdha të remitancave ishin nga institucionet financiare jobankare (IFJB) me pjesëmarrje prej 56,31 %, pasuar nga kanalet e

tjera me 23,34 % dhe bankat me 14,98 %. Për sa iu përket aseteve të kompanive të sigurimit, BQK-ja tregon se deri në këtë muaj vlera e tyre ishte 318,62 milionë euro, duke shënuar rritje prej 1,62 milion eurosh krahasuar me muajin paraprak. Ndërsa asetet e fondeve pensionale kanë arritur vlerën e 2,90 miliardë euro, dominuar nga Letrat me Vlerë të Kapitalit me 78,14 % të gjithsej aseteve. Në fund, BQK-ja tregon se asetet e ndërmjetësve të tjerë financiarë në fund të muajit maj 2024 janë rritur për 11,42 milionë euro, duke arritur vlerën e 583,67 milionë eurove.



## Zyrtarë të bankave në Prishtinë raportojnë dy raste të deponimeve të parave të falsifikuara



**PRISHTINË, 26 QERSHOR** - Policia e Kosovës ka njoftuar për dy raste, ku zyrtarë të bankave kanë raportuar se janë bërë deponime të parave të falsifikuara. Në njërin rast deponimi është bërë edhe nga kompani vendore. "Prishtinë: 11.06.2024 - NN. Më

25.06.2024 ankuesi mashkull kosovar, zyrtar i një banke, ka raportuar se disa kompani vendore dhe persona kanë deponuar para të falsifikuara që nga viti 2023 e deri më tanë. Parat e falsifikuara rreth 705 euro janë konfiskuar. Rasti në hetime. Prishtinë:

03.01.2024-08.03.2024 - NN. Më 25.06.2024 ankuesja femër kosovare, zyrtare e një banke, ka raportuar se në bankë janë deponuar para të falsifikuara. Parat e falsifikuara rreth 628 euro janë konfiskuar. Rasti nën hetime", ka njoftuar Policia e Kosovës.

# Nga Ursula von der Leyen tek Antonio Costa, cilët janë emrat e vjetër e të rinj në BE



Duket se para samitit të BE, Ursula von der Leyen e ka emërimin të garantuar. Negociatorë të Partive Popullore Europiane, socialdemokratëve dhe liberalëve ranë dakord për këtë para samitit të BE, bëri të ditur agjencia gjermane e lajmeve, dpa. Megjithatë von der Leyen nuk e ka ende të garantuar postin. Ajo ka nevojë në Parlamentin European për një shumicë absolute të 361 nga 720 deputetë. PPE, socialdemokratët e liberalët kanë bashkë shumicën në parlament, por ka mundësi të mosvotimit pro von der Leyen, pasi nuk ekziston detyrimi i votimit sipas grupit parlamentar. Por kjo do dihet në seancën themeluese të Parlamentit të ri European në korrik në Strasburg.

**Edhe për postin e kreut të Këshillit të BE ka një emër. Antonio Costa, ish-kryeministër portugez. Po kush është Antonio Costa?**

Në Portugali atë e quajnë "kafshë politike". Vërtet Antonio Costa një pjesë të madhe të jetës së tij ia ka kushtuar politikës. Në vitin 1974 si i ri ai përfjetoi Revolucionin e Karafilave kundër diktaturës, më pas u

aktivizua në organizatën rimore socialiste, si student i juridikut kreu praktikë në kabinetin e presidentit, Jorge Sampaio. António Costa ka qenë deputet portugez, eurodeputet dhe ministër. Ai ka qenë kryetar bashkie i Lisbonës dhe në vitin 2015 kryeministër portugez. Në vitin 2022, portugezët e rizgjodhën me shumicë absolute sërisht, por në nëntor 2023 një skandal korrupzioni e nxori atë jashtë politikës. Prokuroria bëri fjalë për "operacionin influencer".

## Ursula von der Leyen duke buzëqeshur

Ishte mëngjes i 7 nëntorit, kur prokurorët portugezë i ranë ziles me një urdhër kontrolli për Palacete de São Bento, rezidencën zyrtare të kryeministrit portugez në Lisbonë. Ishte një nga gjithsej 42 kontrollle nëpër ministri, seliti e kompanive, bashki dhe shtëpi private. U arrestuan pesë persona duke përfshirë shefin e zyrës së Costës, Vitor Escária. Kosta reagoi brenda ditës. Disa orë më vonë, ai i paraqiti dorëheqjen presidentit Marcelo Rebelo de Sousa. Duke folur përmes mediat, ai u shpreh i habitur nga lajmi se ndaj tij është

hapur një çështje penale. Por sigurisht ai është "i gatshëm të bashkëpunojë me gjyqësorin në mënyrë që e gjithë e vërteta të dalë në dritë". Në të njëjtën kohë, ai njoftoi se nuk do të kandidojet në zgjedhjet e parakohshme parlamentare dhe se donte të përqendrohej në vërtetimin e pafajësisë së tij.

## Gabime në hetime – Costa rehabilitohet

Nuk kaloi shumë kohë dhe prokurorisë iu desh të pranonte gabime serioze në hetim. Akuzat ndaj Costës bazoheshin në biseda telefonike të përgjuara në të cilat përmendej mbiemri i kryeministrit. Por ky është mbiemr mjaft i zakonshëm në Portugali, supozimi se me këtë ishte fjala për politikanin Costa doli të ishte një gabim. Që atëherë, dy gjykata dolën në përfundimin, se provat ishin të pamjaftueshme. Miqësia e ngushtë mes Costës dhe një sipërmarrësi të akuzuar nga prokuroria gjithashtu nuk mjafton për një hetim. Më 17 prill, një gjykatë tha se prokuroria kishte mbledhur vërtet 1000 faqe, por këto ishin kryesisht copëza nga gazetat, por jo prova.

Çështja ende nuk është mbyllur përfundimisht, por politikani 62-vjeçar konsiderohet i rehabilituar në Portugali. Dorëheqja e tij nuk shihet më si një pranim faj, por si një hap i guximshëm i "kafshës politike" për t'u mbrojtur. Në zgjedhjet për Parlamentin European në qershor, socialistët morën sérish shumicën e votave në Portugali. Dhe Luis Montenegro, pasardhësi konservator i Costës si kryeministër, njoftoi herët se do të mbështete Kostën në kandidaturën e tij për postin e Presidentit të Këshillit të BE-së. Edhe Socialistët e Portugalisë e shohin Ursula von der Leyen si një presidente të mirë për Komisionin European – ashtu si miqtë e saj të partisë spanjolle. Me dyshen Ursula von der Leyen dhe Costa, ikerikët shpresojnë për më pak kritere të ashpra në kthimin tek disiplina buxhetore, që mund të ulë rishtazi zhvillimin e mirë aktual ekonomik. Si kryeministër, Costa i dha fund politikave shtrënguese të kursimit me një program të suksesshëm stimulues ekonomik. Kurse von der Leyen më në fund mund të shpresojë për një partner të vërtetë në krye të Këshillit të BE-së, pasi presidenti i mëparshëm i Këshillit, Charles Michel ishte shfaqur gjithmonë e më hapur si rivali i saj.

## Përblytje dhe lumenj të dalë nga shtrati, një i vdekur

Moti i keq ka prekur Italinë, duke shkaktuar një viktimë. Si pasojë e reshjeve të dendura të shiut në zonën e Parmës, një 85-vjeçar humbi jetën pas vërvshimit të përroit të Terminës.

Trupi i tij u gjet nga zjarrfikësit rrëth orës 20:00 në Lido Valtermina, në komunën e Traversetolo. Moti i keq ka shkaktuar edhe përblytje të disa përrenjve dhe kanaleve.

Lumenjtë dolën nga shtrati, nga Apeninet në fushën midis Modenës dhe Piacenza, ku është dhënë alarmi i kuq, duke detyruar evakuimin e personave të rrezikuar.

Dhjetëra rrugë janë bllokuar nga rrëshqitjet e dheut dhe balta në kodra dhe male, ndërsa përblytje janë shënuar në katet e poshtme të banesave dhe janë shembur ura të vogla.





## Tri skuadra të hendbollisteve në gara evropiane

**PRISHTINË, 26 QERSHOR** - Si në asnjë sport tjetër, Federata e Hendbollit e Kosovës do të paraqitet me tri skuadra të sportisteve në garat evropiane. Kampioni, Istogu,

fituesi i Kupës, Ferizaj, dhe Samadrexha, që ishte në gjysmëfinale të plejofit dhe të turneut të Kupës, janë paraqitur për të garuar në Kupën Evropiane,

përkatësisht në EHF European Cup. Të gjitha ekipe pjesëmarrëse pritet të konfirmohen brenda pak ditësh e më pas do të tërhoqet shorti. Të tri skuadrat kanë

përvojën evropiane, ndërsa synojnë ta bëjnë hapin para. Sa iu takon skuadrave të hendbollistëve, afati për paraqitje për gara evropiane është ende i hapur.



**KAZAN, 26 QERSHOR** - Trajneri i skuadrës ruse Rubin Kazan, Rashid Rakhimov, ka folur për sulmuesin Mirlind Daku, të cilin e ka kritikuar për veprimin e tij pas ndeshjes së Kombëtares së Shqipërisë me Kroacinë në "Euro 2024". Daku bëri një veprim aspak të zgjuar pas ndeshjes me Kroacinë, pasi mori altoparlantin dhe nisi fyerjet ndaj serbëve dhe maqedonasve derisa ishte para tifozëve shqiptarë. Reagimet pas këtij veprimi ishin të shumta, ndërsa UEFA e suspendoi sulmuesin shqiptar me dy ndeshje, duke ia pamundësuar ta luajë ndeshjen e fundit të grupit ndaj Spanjës. Pas dënimit nga UEFA, u raportua se edhe klubi i tij, Rubin Kazan, do ta dënononte, por trajneri i klubit rus, Rakhimov, ka lënë të kuptohet se Daku të do të mbetet pjesë e kësaj skuadre edhe në sezoni e ri. Rakhimov në një intervistë përfaqen zyrtare të klubit u pyet fillimisht se cili është qëndrimi i tij në lidhje sjelljen e Dakut në "Euro 2024", ndërsa nuk ngurroi të përgjigjej. "Pse duhet ta trajtoj këtë disi pozitivisht? Sigurisht që është negative. Këtu nuk duhet ta mposht gjendjen emocionale të lojtarit. Mendoj se ai është i vetëdijshëm për gjithçka, kuqton gjithçka në mënyrë të përkryer dhe duke folur me të, e bëra të kuptojë se cilat gjëra janë të drejta dhe cilat janë të gabuara.



Ai është, para së gjithash, një futbollist që duhet të mendojë t'i tregojë cilësitet më të mira në fushë", ka thënë Rakhimov përfaqen zyrtare të klubit. Më tutje, trajneri i Dakut u pyet në lidhje nëse pas këtij gjesti të sulmuesit shqiptar mund të lindin probleme në ekip, por ai nuk mendon se kjo do të ndikojë. "Mos e mendo. Mirlindin të gjithë e njohin shumë mirë. Nuk ka zemërim në veprimet e tij. Ai është mjaft i shoqërueshëm dhe e di që ai është shumë i shqetësuar për këtë tani, por ju jeni një i rritur, duhet të mendoni se çfarë po bëni. Nuk mendoj se asnjë prej nesh që qëndrojmë këtu e jeton jetën tonë pa bërë gabime. Ju mësoni nga gabimet dhe shpresoj se ky do të jetë një mësim i mirë përfunduar trajneri i Rubin Kazanit.

Në fund Rakhimov u pyet nëse ka ndonjë zhgënjim të veçantë përkëtë. "E di që duhej të luante kundër Spanjës. Mendoj se, para së gjithash, është i zhgënjyer, sepse e kuqton shumë mirë që e priste këtë moment. Dhe, përfat të keq, ai nuk i kontrolloi këtë emociione, por ato duhet të kontrollohen", ka shtuar ai. "Mendoj se ai duhet të qetësohet para së gjithash, ta kuqtojë gabimin. Ai duhet të jetë shembull për ekipin dhe të përmirësohet. Jam i bindur se Mirlindi do ta bëjë këtë. E kemi studiuar shumë mirë këtë vit. Tani duhet t'i japij një pushim që të vijë në vete dhe ta kuqtojë sërisht këtë moment. Ju nuk keni nevojë të mendoni përfatë gjatë. Ai duhet ta korrigojë këtë gabim me vepra", ka përfunduar trajneri i Rubin Kazanit.

## Daku: 'Euro 2024', përvøjë jo shumë e mirë përmua

**TIRANE, 26 QERSHOR** - Kombëtarja e Shqipërisë e mbaroi aventurën në "Euro 2024". "Kuqezinjtë" u gjendën në "Grupin e Vdekjes", me kundërshtarë tejet të fortë si: Spanja, Italia dhe Kroacia. Skuadra e Sylvinhos arriti të marrë vetëm një pikë në përballjen me Kroacinë, që përfundoi 2-2, kurse u mposht nga Italia 2-1 dhe Spanja 1-0. Në përgjithësi futbollistët shqiptarë treguan paraqitje dinjitoze, pa u turpëruar nga kombëtaret me famë botërore. E të martën ata veçse mbërritën në Aeroportin e Rinast. Aty, një nga futbollistët më të përfolur të kombëtares, Mirlind Daku, dha një intervistë përmuat

mediet shqiptare. Ai deklaroi se "Euro 2024" nuk ishte dhe aq përvøjë e mirë përmua. "Ka qenë një eksperiencë e mirë përgjithë grüp, por përmua jo shumë e mirë, duke e parë atë rastin që ndodhi. Por nuk kemi çfarë të bëjmë. Kombëtarja po rritet më shumë dhe jam i kënaqur që isha pjesë e saj në 'Euro 2024'. Sylvinho u ndje krenar që e kemi përfaqësuar shumë mirë. Ne dinim që ky ka qenë grüp i vështirë", ka thënë Daku, i cili ishte dënuar me dy ndeshje moslojë nga UEFA për shkak të pjesëmarrjes në thirrjet ofenduese ndaj serbëve dhe maqedonasve.



## Trepça mëson kundërshtarët në kualifikimet e Ligës së Kampionëve



**MITROVICË, 26 QERSHOR** - Kampionia e Kosovës, Trepça, ka mësuar kundërshtarët në kualifikimet e Ligës së Kampionëve. Kjo është hera e parë që mitrovicasit janë pjesë e kualifikimeve të kësaj gare. Në

turneun kualifikues do të përballen me skuadrën e Keravnos (Qipro), ndërsa fituesi i këtij takimi luan në gjysmëfinale kundër kampionit të Çekisë, Nymburk. Nëse arrin në finale, Trepça do të luajë përballë fituesit

nga takimet në mes të Kutaisi (Gjeorgji), Levice (Sllovakia) e Kalev/Cramo (Estonia). Katër turnetë e raundit kualifikues do të zhvillohen midis 15 shtatorit dhe 22 shtatorit. Orari i ndeshjeve, si dhe vendi i

zhvillimit, do të shpalen në korrik. Në kualifikime janë 24 skuadra që do t'u bashkohen 28 skuadrave që tashmë janë përcaktuar për edicionin e ri. Edicioni i ri do të fillojë më 1 tetor 2024.

## Drita transferon ish-lojtarin e PSG-së

**GJILANI, 26 QERSHOR** - Skuadra e Dritës nga Gjilani ka njoftuar se e ka transferuar ish-sulmuesin e PSG-së, Alexandre Fressange. 23-vjeçari ka nënshkruar me skuadrën e Kosovës një kontratë

dyvjeçare me mundësi vazhdimi edhe për një vit tjetër. "Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë që kemi siguruar shërbimet e sulmuesit Alexandre Fressange. Fressange është 23-vjeçar. Vjen

nga Parisi i Francës, ku ishte pjesë e ekipeve zinxhirë të PSG-së dhe në vitin 2018 nënshkroi kontratë profesionale me PSG-në me ekipin e parë dhe, së fundmi, ishte pjesë e Paris FC.

Alex ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me ne, me mundësi vazhdimi edhe për një vit tjetër dhe do të jetë një forcë shështë e ekipit tonë", thuhet në njoftimin e Dritës.



## Xhaka: Gëzimi i Gjermanisë pas ndeshjes tregon shumë për forcën tonë

**FRANKURT, 26 QERSHOR** - Zvicra po përgatitet të përballet me Italinë e Luciano Spallettit në sfidën e vlefshme për 1/8 e Kampionatit Evropian, Gjermani 2024, të planifikuar për të shtunën në orën 18:00.

Në një prononcim të bërë së fundmi për mediet, kapiteni i Zvicrës, Granit Xhaka, deklaron se ndeshja ndaj Gjermanisë tregon shumë për forcën e tyre. "Të them të drejtën, Zvicra ka fituar më

shumë respekt falë ndeshjes me Gjermaninë dhe unë besoj se ngazëllimi i çmendur i gjermanëve pas barazimit është provë për këtë. Ne e mbyllëm fazën e grupeve me të fortë dhe me një lojë që ka

nxjerrë në pah gjithë karakterin tonë. Nëse shohim se ku ishim gjashtë muaj më parë, sot shoh një skuadër me një mentalitet krejtësisht të ndryshëm", ka deklaruar Xhaka.



## Yakin: Nuk na shqetëson Italia

**CYRIH, 26 QERSHOR** - Trajneri i Zvicrës, Murat Yakin, ka theksuar edhe një herë vetëbesimin e madh që ka grupi i tij i lojtarëve para ndeshjes së madhe ndaj Italisë. Zviceranët impresionuan në Grupin A, duke fituar 3-1 ndaj Hungarisë në ndeshjen hapëse, para se të ndaleshin me barazim nga Skocia në ndeshjen e dytë. Në takimin e fundit të grupit, Zvicra e ndali me barazim Gjermaninë, po ashtu ishte afër fitores në minutat e fundit. Gjérat kanë shkuar më vështirë për Italinë, që mezi fitoi ndaj Shqipërisë 2-1, para një humbe të dhimbshme prej 1-0 nga Spanja. Ndeshje tejet e vështirë i doli edhe me Kroacinë, duke siguruar një barazim vetëm në fryshtë e fundit. Duke folur për median zvicerane "Srf", Yakin diskutoi përmendësinë që do t'i futen duelit ndaj Italisë. "Nuk mund të themi se jemi favorit, sepse po përballemi me Italinë, por



barazimi ndaj Gjermanisë na ka dhënë shumë vetëbesim dhe nuk mund ta fshehim", ka thënë ai. "E kemi ndjekur ndeshjen e Italisë me kujdes, kemi analizuar taktikat dhe strategjinë. Singerish mezi po presim. Ata janë të paparashikueshmë, por

ne jemi gati. Ne kemi mjaftueshmë kualitet t'i bëjmë ballë një ndeshje si kjo. Në realitet, ne nuk shqetësohem fortë për Italinë. Ajo duhet të shqetësohet për ne, sepse neve po na shkon më mirë kampionati", ka shtuar Yakin.

## Shefi i Mercedesit: Dy podiume radhazi janë një sinjal pozitiv, tani është koha për fitore

**BARCELONË, 26 QERSHOR** - Dy podiume në dy garat e fundit kanë rikthyer entuziazmin te makina Mercedes, që sheh se risitë e aplikuara së fundi po jepin rezultat. Fillimisht Russell e më pas Hamiltoni po rikthejnë Mercedesin në podium, me 7 herë kampionin e botës që e bën këtë gjë prej 18 sezonesh radhazi në Formula 1. "Ne e dinim që Barcelona do të ishte një matës i mirë i progresit tonë të fundit. Ekipi punoi shumë për të përmirësuar W15 në kthesat e shpejta, siç është pista e Barcelonës. Këto përmirësimë na ndihuan të përfitonim nga momenti i Montrealt", komentoj Toto Wolff, shefi i Mercedesit. "Edhe pse nuk kishim ritmin përtë konkurruar për fitore, ishte inkurajuese të ishim në grup. Ne shkojmë në Austri me qëllim që të vazhdojmë të bëjmë progres pozitiv. Është një qark shumë i ndryshëm nga fundjava e kaluar", ka shtuar më tej Wolff. "E dimë se



ka ende punë për të bërë për të pasur një shans realist për të luftuar për fitore. Puna po vazhdon dhe jemi në një trajktore pozitive. Gara e radhës ka shumë

kthesa me shpejtësi të ulët e të mesme si dhe disa drejtime të gjata. Do të jetë një sfidë e mëtejshme për makinën tonë", u shpreh menaxheri i Mercedesit.

## Unitedi synon rikthimin e Moratas në Premierë Ligë

Sulmuesi Alvaro Morata mund të rikthehet në Premierë Ligë sezonin tjetër. Është skuadra e Manchester United ajo që është interesuar për sulmuesin që luan me Atletico Madridin në Spanjë. Sipas medieve britanike,

drejtuesit e "djave të kuq" janë duke biseduar me përfaqësuesit e Moratas, teksa po shqyrtojnë një lëvizje të volitshme për ish-sulmuesin e Chelseas. Morata shënoi 24 gola gjatë një sezoni e gjysmë me fanellën e Chelseat

gjatë kohës që qëndroi në Londër. 31-vjeçari, që është golashënesi i katërt më i mirë i Spanjës i të gjitha kohëve, ka kontratë me Atletico Madridin deri në verën e vitit 2026. Gjithsesi, disa herë është folur

kohët e fundit se lojtari mund të përfundojë në stolin e skuadrës "colchoneros" sezonin e ri. Edhe vetë Morata ka thënë se pranon më mirë të largohet sesa të qëndrojë në stol. Ndaj dhe te Manchester United po shohin

këtë mundësi, për të sjellë në Premierë Ligë një sulmues me përvojë dhe që e njeh këtë kampionat. Morata, aktualisht i grumbulluar me kombëtaren spanjolle, pret të mësojë lajme përtë ardhmen e tij.

## SHKURT

### Mario Mitaj dhe Medon Berisha, rekordmenët kuqezi në 'Euro 2024'


Talentët e Kombëtares së Shqipërisë, Mario Mitaj dhe Medon Berisha, vendosën rekorde me fanellën kuqezi në "Euro 2024". Kombëtarja e Shqipërisë mbylli aventurën në Kampionatin Evropian, duke përfunduar e katerta në Grupin B, me vetëm një pikë. Kuqezinjëtë në tri ndeshjet e grupeve humbën nga Italia me rezultat 2-1, barazuën 2-2 me Kroacinë dhe në fund u moshtën 1-0 nga Spanja. Megjithatë, pati disa gjëra pozitive në këtë kampionat evropian. Një nga to ishte paraqitura e lojtarëve të rinx. Mario Mitaj, i konfirmuar tashmë si zgjedhje e parë në krahun e majtë të mbrojtjes dhe lojtari i ardھur nga ekipi i U-21, Medon Berisha, vendosën rekordë. Mbrojtësi i majtë arriti në ndeshjen e parë ndaj Italisë ta thyejë rekordin e Elseid Hysajt duke u bërë lojtari më i ri që luan me kombëtaren në një kampionat evropian. Mitaj zhvilloi ndeshjet e para me vetëm 20 vjet, 10 muaj e 9 ditë, por disa ditë më vonë rekordi i tij u kthye nga bashkëlojtari i ri Medon Berisha. Mesfushori i talentuar i Lecces vendosi rekordin e ri me 20 vjet, 8 muaj e 3 ditë, si lojtari më i ri që luan me kombëtaren në një kampionat evropian.

### Broja dëshiron të largohet nga Chelsea

Armando Broja ka kërkuar të largohet nga Chelsea. E përditshmja britanike "Daily Express" shkruan se sulmuesi shqiptar ka biseduar me klubin londinez me anë të agjentëve të tij, duke e bërë të qartë se kërkon një përvojë tjetër. Për momentin ai ka kontratë deri në vitin 2028. Broja jo vetëm që dëshiron të ikë nga Chelsea, por pritet ta braktisë edhe Premierë Ligën. "Express" shqaron se futbollisti dhe rrëthi i tij mendojnë se stilit të tij të lojës i përshtatet më shumë futballi i Serisë A, duke qenë se shpejtësia e tij, shpërthimi dhe loja në ajër mund të bëjnë më shumë punë në Itali, ku lojtarët nuk janë aq të përgatitur fizikisht sa në Angli. Broja pëlqehet edhe nga Evertoni dhe West Hami si dhe nga Stuttgarti në Bundesliga. Në disa vjet si profesionist, Armando ka luajtur në Holandë te Vitesse, te Southamptoni e Fulhami në elitën angleze, si dhe me "blutë" e Chelseas, të cilët kartonin e tij e vlerësojnë 30 milionë paundë.

### Fullkrug: Ja si e fitojmë Evropianin

Sulmuesi punëtor i Borussia Dortmundit dhe i kombëtares gjermane ka fituar vazhdimesh vlerësimë që nga fillimi i Kampionatit Evropian: dy gola në tri ndeshje (kundër Skocisë dhe Zvicrës) dhe gjithmonë aktivizohet nga stoli gjatë ndeshjes. Goli më me peshë ishte ai në minutën e 92-të kundër zviceranëve (1-1) që i lejoi Gjermanisë të kalonte në raundin e 1/8-ave si lider i Grupit A. Megjithatë, kur përshkruan momentin e tij madhështor në kombëtare, Niclas Fullkrug ka qëndruar gjithmonë i përulur dhe i singertë ndaj vetes: "Nuk kam asnjë sekret. Nuk jam mësuar të nis nga stoli te Borussia Dortmundi, por është e rëndësishme të sjell energji në fushë. Nuk ishte një gol që na shpëtoi nga eliminimi, por na ndryshoi rrugën. Në parim do të kemi kundërshtarë më pak të fortë se nëse do të kishim dalë të dytë. Sidoqoftë, çdo skuadër ka pikat e veta të forta dhe nëse duam të bëhem kampionë të Evropës, duhet t'i mundim të gjithë. Por duhet të shikojmë vete", ka shtuar 31-vjeçari gjerman për "Marca".



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




[facebook](http://www.facebook.com/gjeipuneshpeite)  [www.facebook.com/gjeipuneshpeite](http://www.facebook.com/gjeipuneshpeite)

## RESTAURANT SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



**Lumé's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
[Sallon Depilimi Lumé's Details](#)  
[lumesdetails](#)  
 Mbrapa Teatr-it, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "E&D DOORS" SH.P.K. me seli në Skenderaj, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812034370 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpaljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "E&D DOORS" D.O.O. Skenderaj, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812034370 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "E&D DOORS" L.L.C. with headquarters Skenderaj, has come to the decision to quit its business: 812034370 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ava Kurteshi B.I. me emër tregtar Ambulanca Neropsikiatrike "Mens Sana" dhe me nr.unik biznesi 810929630 shpallë të pavlefshme certifikatën e humbur.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afér "Bill Clintonit", katë tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afér Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada - Government

Trepça Shoqeri Aksionare  
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qera te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 26.06.2024 bënë shpallje publike për dhënien e pronës së paluajtshme me qera.

### Shpallje Publike T-24-8

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça Sh.A.

Adresa e AK:  
Parku Industrial  
MITROVICË  
40000

Personi Kontaktues:  
Behxhet Nimani  
E-mail:  
behxhetnimani@hotmail.com  
Telefoni:  
+381 28 538 050  
Faks:  
+381 28 539 202

#### Shpallja Publike

##### Qëllimi i ofertës:

- Dhënie me qera e parcelave në Njësinë Biznesore Industria Kimike
- Sipërsaqe dhe çmimi filletar

#### 1. Njësia Biznesore Industria Kimike

| Njësia Biznesore Industria kimike |  |  |                |          |                   |                      |
|-----------------------------------|--|--|----------------|----------|-------------------|----------------------|
| Nr                                | Emri i Objektit                                      | Siperfaqja e pambuluar (m <sup>2</sup> ) | Çmimi neto (€) | TVSH (€) | Çmimi me TVSH (€) | Gjithsejt qeraja (€) |
| 1                                 | Parcela me numer 1A pranë magjistrale së Adriatikut  | 750.00                                   | 0.50           | 0.09     | 0.59              | 442.50               |
| 2                                 | Parcela me numer 2A pranë magjistrale së Adriatikut  | 750.00                                   | 0.50           | 0.09     | 0.59              | 442.50               |
| 3                                 | Parcela me numer 4A1 pranë magjistrale së Adriatikut | 1,000.00                                 | 0.50           | 0.09     | 0.59              | 590.00               |
| 4                                 | Parcela me numer 4A2 pranë magjistrale së Adriatikut | 1,000.00                                 | 0.50           | 0.09     | 0.59              | 590.00               |
| 5                                 | Parcela me numer 4A3 pranë magjistrale së Adriatikut | 1,084.00                                 | 0.50           | 0.09     | 0.59              | 639.56               |
| 6                                 | Parcela me numer 7A pranë magjistrale së Adriatikut  | 1,130.00                                 | 0.50           | 0.09     | 0.59              | 666.70               |
| 7                                 | Parcela me numer 8A pranë magjistrale së Adriatikut  | 2,400.00                                 | 0.50           | 0.09     | 0.59              | 1,416.00             |
| 8                                 | Parcela me numer 9A pranë magjistrale së Adriatikut  | 2,000.00                                 | 0.50           | 0.09     | 0.59              | 1,180.00             |

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë

Data e shpalljes: 26.06.2024

Sqarimi: deri me 15.07.2024

Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 15.07.2024

Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë.

Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te myllur) (Originali dhe Kopja)

Afati i fundit i dorëzimit: 15.07.2024 në 11:00

Vendi i dorëzimit: Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A.

Parku Industrial, Mitrovicë (PIM)

Kërkesat minimale të kualifikimit:

1. Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
2. Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH ( vetëm për ofertuesit vendor)
3. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njofitimit për kontratë.
4. Nuk ka obligime ndaj Trepçës të pa paguara.

#### Shënimë shtesë:

**Çmimi i ofertës:** Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madh apo i barabartë me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.

**Obligimet:** Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe te gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.

**Oferta:** Duhet të përfshijë çmimin për m<sup>2</sup> duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks1.

**Pagesa:** Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkerkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.

**Operatorët ekonomik:** që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

#### Aneksi 1

#### OFERTA

| Emri i OE: |  |
|------------|--|
| Loti       |  |
| Kodi (T)   |  |

| Llogarita e qerasë për sipërafaqen e pa mbuluar |   |  |
|---|---|--|
| a   | Siperfaqe e pa mbuluar m <sup>2</sup>                 |  |
| b   | Çmimi për meter katrore m <sup>2</sup> në (€) pa TVSH |  |
| c=b*18%   | TVSH e çmimit për meter katrore m <sup>2</sup> në (€) |  |
| d=b+c   | Çmimi për meter katrore m <sup>2</sup> në (€) me TVSH |  |
| e=a*d   | Gjithsejt qeraja me TVSH në (€)                       |  |
| e=c+d   | Për pagesë në (€)                                     |  |

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

|             |  |
|-------------|--|
| Nënshkrimi: |  |
| Data:       |  |
| Vula:       |  |

#### Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhënie me qira te pronës se paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimive, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përban informata përbajtësisht të gabueshme ose mashtuese.

| Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE) |  |
|---|--|
| Emri i OE:                              |  |
| Adresa e plotë:                         |  |
| I përfaqësuar nga:                      |  |
| Emri:                                   |  |
| Pozita:                                 |  |
| E-mail:                                 |  |
| Tel:                                    |  |
| Nënshkrimi:                             |  |
| Data:                                   |  |
| Vula:                                   |  |

#### Aneks 3. Pjesëmarrja

Pjesëmarrja - Marja e Aplikacionit mund të behet deri me datën 15.07.2024 deri në orën 11.00 për mes e-mail ose në Zyrën e Shitjes.

#### Aneks 4. Përshtkimi i Aseteve

Përshtkimi i aseteve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qellime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësish së përshtkimit. Këto asete jepen më kushte të gjendjes aktuale "ashtu siç janë dhe ku janë" dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garacionin më lidhje me gjendjen e aseteve. Tenderuesi bartë rrezikshmérinë e plotë për gjendjen e aseteve.

Objekti është i ndarë në lotë,

**Trepça Sh.A.** përmes këtij njofitimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshnauar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.

#### DHËNIE ME QIRA E PARCELAVE

Oferta duhet të jepet për m<sup>2</sup> dhe llogarita përfundimtare në faturim

**MEKA**  
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA  
1992





**ROYAL CROWN**  
**RC**  
cola

## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fludi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1905

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
0.5L